

NJOFTIM
Nr. 8339, datë 11.5.2021

PËR SHITJE ME ANKAND TË PRONËS SHTETËRORE, NË ADMINISTRIM TË
MINISTRISË SË BRENDSHME

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014, “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes”, të ndryshuar, kapitulli III, shpall për shitje me VAM të ulur, si më poshtë:

1. Në administrim të Ministrisë së Brendshme

Nr.	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lek)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit (mjete kryesore + truall)	Mjetet kryesore	Truall			Data	Ora	Vendi
1	Posta e Policisë, Dukagjin	Breglumi, qarku Shkodër	2 202 469	2 100 798	101 671	347	347	9.6.2021	13:00	DDPP

Çdo person fizik apo juridik i interesuar për blerje me ankand duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit, dokumentacionin si më poshtë:

1. Kërkesë me shkrim për blerjen e objektit apo të ndërmarrjes e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. Mandatpagesën apo garancinë bankare në origjinal, që vërteton derdhjen apo ngurtësimin e 20% të vlerës së fillimit të ankandit, në lek, për llogari të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

3. Dokument identifikimi (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

Shënim. Pjesëmarrësi në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e objektit të shpallur për shitje, nuk i kthehet 20% e vlerës fillestare, të ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Subjekti i shpronësuar i truallit mbi të cilin ndodhet objekti apo ndërmarrja duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit dokumentacionin si më poshtë:

1. Kërkesë me shkrim për blerjen e objektit apo ndërmarrjes e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. Mandatpagesën apo garancinë bankare, që vërteton ngurtësimin e 20 përqind të vlerës fillestare, në lek, vetëm për objektin (mjete kryesore), për llogari të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, detyrimisht brenda afatit të pranimit të kërkesave.

3. Vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, të shoqëruar me planvendosjen e pronës, ku përcaktohet se ai është subjekt pronar i tokës.

4. Dëshminë e trashëgimisë, prokurë përfaqësimi etj., nëse ka të tilla.

5. Deklaratë noteriale, në të cilën trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar, që kërkojnë të ushtrojnë të drejtën e parablerjes për objektin në proces privatizimi, të deklarojnë se, që nga momenti që janë pajisur me vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, nuk kanë përfituar kompensim në asnjë nga format e parashikuara në ligj. Gjithashtu, të deklarojnë se vendimi i ish-Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ose i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave nuk ka ndryshuar ose është shfuqizuar me ndonjë akt administrativ apo vendim të formës së prerë.

Mandatpagesa apo garancia bankare duhet të bëhet detyrimisht brenda afatit të pranimit të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Mandatpagesa apo garancia bankare mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Ministrinë e Financave dhe

Ekonomisë, pasi të keni tërhequr pranë DDPP-së ose degëve të thesarit në rrethe faturën për arkëtim të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Këto informacione gjenden edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financave: www.financa.gov.al.

NJOFTIM
Nr. 8339, datë 11.5.2021

PËR SHITJE ME ANKAND TË PRONËS SHTETËRORE, NË ADMINISTRIM TË INSTITUTE TË PËRGATITJES SË QENVE TË POLICISË, TIRANË

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014, “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes”, shpall për shitje me VAM fillestar si më poshtë:

1. Në administrim të Institutit të Përgatitjes së Qenve të Policisë, Tiranë

Nr.	Emërtimi	Datëlindja	Vendndodhja	Vlera fillestare e ankandit në lek	Zhvillimi i ankandit		
					Data	Ora	Vendi
1	Qeni Flaka	26.5.2019	Tiranë	15,000	9.6.2021	09:00	DDPP
2	Qeni Erika	26.5.2019	Tiranë	15,000	9.6.2021	09:15	DDPP
3	Qeni Laika	13.6.2019	Tiranë	15,000	9.6.2021	09:30	DDPP
4	Qeni Soni	9.11.2019	Tiranë	8,000	9.6.2021	09:45	DDPP
5	Qeni Korabi	26.4.2012	Tiranë	8,000	9.6.2021	10:00	DDPP
6	Qeni Keja	18.5.2012	Tiranë	8,000	9.6.2021	10:15	DDPP
7	Qeni Lisi	22.6.2019	Tiranë	20,000	9.6.2021	10:30	DDPP
8	Qeni Uga	22.6.2019	Tiranë	20,000	9.6.2021	10:45	DDPP
9	Qeni Asta	22.6.2019	Tiranë	20,000	9.6.2021	11:00	DDPP
10	Qeni Kuant	17.7.2019	Tiranë	15,000	9.6.2021	11:15	DDPP
11	Qeni Dika	26.11.2019	Tiranë	15,000	9.6.2021	11:30	DDPP

Çdo person fizik apo juridik i interesuar për blerje duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit dokumentacionin si më poshtë:

1. **Kërkesë me shkrim** për blerje e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. **Garancinë bankare apo mandatpagesën** në origjinal, që vërteton ngurtësimin e 20% të vlerës së fillimit të ankandit, në lek, për llogari të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

3. **Dokument identifikimi** (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

Shënim. Pjesëmarrësit në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën shpallur për shitje, i konfiskohet 20% e garancisë bankare, e ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Garancia bankare apo mandatpagesa duhet të bëhet detyrues brenda afatit të pranimit të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Garancia bankare apo mandatpagesa mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, pasi të keni tërhequr pranë DDPP-së ose degëve të thesarit në rrethe faturën për arkëtim të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Këto informacione gjenden edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë: www.financa.gov.al.